



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, datë 14.04.2017

PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR,
BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 58 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 671, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Bashkisë Tiranë si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 83, datë 29.12.2016, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tiranë, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtme:
 - a) Strategjia Territoriale, shoqëruar me përmbledhjen e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
 - b) Plani i Zhvillimit të Territorit, shoqëruar me Shtojcën I, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit;
 - c) Rregullorja e Planit;
 - d) Vlerësimi Strategjik Mjedisor;
 - e) Materiali hartografik:
 - i. Vizioni strategjik;
 - ii. Ndarja e territorit në 5 sisteme;
 - iii. Ndarja e territorit në njësi;
 - iv. Përdorimi i propozuar i tokës sipas 14 kategorive bazë;
 - v. Infrastruktura e transportit;
 - vi. Fazat e zbatimit të PPV-së.
2. Autoriteti përgjegjës për miratimin e Planeve të Detajuara për Zonat me Rëndësi Kombëtare është Këshilli Kombëtar i Territorit, me propozim të Ministrit përgjegjës.

3. Gjatë hartimit të Planeve të Detajuara Vendore, projekteve strategjike, projekteve pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti tjetër për zhvillimin e territorit, Bashkia Tiranë duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Përgjithshëm Vendor.
4. Ngarkohet Bashkia Tiranë për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësisë.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen studimet urbanistike/dokumentet e planifikimit të miratuara më parë nga KRRTRSH/KKT për territorin administrativ të Bashkisë Tiranë përfshirë, por pa u kufizuar në to, si më poshtë:
 - Vendim Nr. 1, datë 15.02.2013 “Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tiranë”;
 - Vendim Nr. 17, datë 04.07.2013 “Instrumenti i Përgjithshëm Vendor komuna Pezë, Qarku Tiranë”;
 - Vendim Nr. 18, datë 04.07.2013 “Instrumenti i Përgjithshëm Vendor komuna Dajt, Qarku Tiranë”;
 - Vendim Nr. 17, datë 10.05.2013 “Instrumenti i Përgjithshëm Vendor, Komuna Kashar, Qarku Tiranë”;
 - Vendim Nr. 18, datë 10.05.2013 “Instrumenti i Përgjithshëm Vendor, Komuna Farkë, Qarku Tiranë”;
 - Vendim Nr. 19, datë 10.05.2013 “Instrumenti i Përgjithshëm Vendor, Komuna Petrelë, Qarku Tiranë”;
 - Vendim Nr. 26, datë 10.05.2013 “Instrumenti i Përgjithshëm Vendor, Komuna Vaqarr, Qarku Tiranë”;
 - Vendim Nr. 21, datë 10.05.2013 “Instrumenti i Përgjithshëm Vendor, Komuna Bërzhitë, Qarku Tiranë”;
 - Vendim Nr. 35, datë 10.05.2013 “Rivlerësim i “Planit Rregullues të Parkut Kombëtar të Dajtit”;
 - Vendim Nr. 4, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e çështjes dhe zonës me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, identifikuar si Kurora e Gjelbër e Tiranës”.
6. Planet e detajuara vendore, lejet e ndërtimit të miratuara në zbatim të dokumenteve të planifikimit të mëparshme, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi.
7. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'E. Gjermeni', is written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISE' at the top, 'MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN' on the sides, and 'TIRANË' at the bottom. A diagonal line is drawn across the stamp.

SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



An official circular stamp is partially obscured by a large, vertical handwritten signature in blue ink. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISE' at the top, 'AGJENCIA E ZHVILLIMIT URBAN' on the sides, and 'TIRANË' at the bottom. The signature is written over the stamp.